

LIGJ
Nr.72/2012

**PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E INFRASTRUKTURËS KOMBËTARE
TË INFORMACIONIT GJEOHAPËSINOR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË¹**

(Ndryshuar me ligjin nr. 103/2024, datë 19.09.2024 dhe ligjin nr. 53/2026 datë 21.05.2026)

I përditësuar

Në mbështetje të neneve 78, **81, pika 1** dhe 83, pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Ky ligj përcakton rregullat për:

- a) krijimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë;
- b) organizimin dhe funksionimin e autoriteteve kombëtare të informacionit gjeohapësinor;
- c) përcaktimin e kushteve të përgjithshme që lidhen me mbledhjen, krijimin, përpunimin, përditësimin, ndërveprimin, aksesin, ruajtjen, përdorimin dhe arkivimin e informacionit gjeohapësinor;
- ç) detyrimet dhe kompetencat e autoriteteve publike për krijimin, sigurinë, aksesin dhe përdorimin e informacionit gjeohapësinor.

Neni 2
Fusha e veprimit

1. Ky ligj zbatohet për të gjitha metadatat, grupet e të dhënave gjeohapësinore dhe shërbimet e tyre që plotësojnë kriteret e mëposhtme:

- a) lidhen me një ose më shumë nga temat e përcaktuara në këtë ligj dhe aktet nënligjore, në zbatim të tij;
- b) lidhen me zona brenda territorit të Republikës së Shqipërisë;
- c) janë në format elektronik;
- ç) mbahen nga dhe për llogari të:
 - i) një autoriteti publik, kur janë prodhuar ose janë marrë nga një autoritet publik apo administrohen ose përditësohen nga ky autoritet dhe përfshihen në fushën e veprimtarisë së tij;
 - ii) një pale të tretë, së cilës i janë vënë në dispozicion shërbimet e rrjetit të të dhënave gjeohapësinore, në përputhje me këtë ligj.

2. Në rastet kur ekzistojnë kopje identike të shumëfishta që u përkasin të njëjtave të dhëna gjeohapësinore, të cilat mbahen nga ose për llogari të autoriteteve publike, ky ligj zbatohet vetëm për versionin origjinal të të dhënave gjeohapësinore, prej të cilit janë krijuar kopjet e tjera.

¹ Ky ligj është përafruar plotësisht me:

Direktivën 2007/2/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 14 mars 2007 “Për ngritjen e një infrastrukture për informacionin hapësinor në Komunitetin Evropian (INSPIRE)”. Numri CELEX: 32007L0002, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, Seria L, nr. 108, datë 25.4.2007, faqe 1 – 14.

Neni 3 Përkufizime

Në këtë ligj, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “ASIG” është Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor.
2. “Autoritet publik” është:
 - a) çdo organ i pushtetit qendror dhe vendor, që kryen funksione administrative, si dhe entet publike që kryejnë funksione administrative;
 - b) çdo person fizik ose juridik, që ka përgjegjësi ose kryen funksione publike apo që ofron shërbime publike nën kontrollin e autoriteteve të parashikuara në shkronjën “a” të kësaj pike.
3. “BIG” është Bordi i Informacionit Gjeohapësinor.
4. “Baza e të dhënave shtetërore” ka të njëjtin kuptim me atë të përcaktuar nga ligji nr. 10 325, datë 23.9.2010 “Për bazat e të dhënave shtetërore”.
5. “Rikuperimi nga katastrofa” është procesi që lidhet me përgatitjen për rikuperim dhe vazhdimësinë e funksionimit të infrastrukturës teknologjike të informacionit me rëndësi të posaçme për autoritetin administrues, pas një katastrofe natyrore ose të shkaktuar nga njeriu.
6. “GIS” është Sistemi i Informacionit Gjeografik që mbledh, ruan, analizon, përpunon dhe paraqet të dhëna që lidhen me një fenomen natyror apo shoqëror, gjeoreferencimi i të cilit mundësohet nga një sistem hapësinor koordinativ i përbashkët.
7. “GIS Kombëtar” është Sistemi Kombëtar i Informacionit Gjeohapësinor, i cili përfshin të gjitha sistemet e informacionit gjeografik që ndërtohen për tema të veçanta, në përputhje me standardet e miratuara nga ASIG-u, që ndërveprojnë me njëri-tjetrin dhe që integrohen nga ASIG-u.
8. “Grup të dhënash gjeohapësinore” është një koleksion i identifikueshëm të dhënash gjeohapësinore.
9. “Gjeoreferencim” është përcaktimi i pozicionit gjeohapësinor të një objekti apo fenomeni duke u mbështetur në një sistem hapësinor koordinativ.
10. “Gjeoportali” është një sistem, i cili nëpërmjet internetit përdor një ndërfaqe grafike qendrore dhe unike, nëpërmjet së cilës përdoruesit mund të zbulojnë, të shikojnë dhe të përdorin informacionin gjeohapësinor dhe shërbimet e rrjetit që lidhen me këtë informacion, sipas përcaktimeve të këtij ligji.
 - 10.1 “Harta bazë” është një hartë që përshkruan apo paraqet informacione gjeohapësinore të realitetit fizik të sipërfaqes së tokës, për të cilën vendosen, përpunohen dhe përditësohen informacione të tjera tematike, sipas temave të përcaktuara në nenin 11, të këtij ligji.
 - 10.2 “Remote Sensing” është teknologjia shkencore e përfuturit të të dhënave, paraqitjes dhe njohjes së informacionit mbi sipërfaqen tokësore dhe të objekteve mbi të, pa qenë në kontakt me to. Kjo mundësohet me anë të “kapjes” së ndijimeve (skanimit) dhe regjistrimit të energjisë së rrezatimit të reflektuar dhe të emetuar nga objektet në dhe mbi sipërfaqen tokësore dhe më pas të përpunimit, të analizimit dhe të përdorimit të informacionit të përfutur.
11. “Informacion gjeohapësinor” janë metadatat, të dhënat dhe grupet e të dhënave gjeohapësinore, që lidhen me një fenomen çfarëdo të realitetit, gjeoreferencimi i të cilit mundësohet nga një sistem hapësinor koordinativ i përbashkët.
12. “Infrastruktura kombëtare e informacionit gjeohapësinor” është infrastruktura që përfshin autoritetet kombëtare përgjegjëse për të dhënat gjeohapësinore, metadatat, grupet e të dhënave gjeohapësinore dhe shërbimet e të dhënave gjeohapësinore, shërbimet e rrjetit dhe teknologjitë, marrëveshjet për shkëmbimin, aksesin dhe përdorimin, si dhe mekanizmat e koordinimit e të monitorimit, proceset dhe procedurat, të krijuara, të vëna në veprim ose të vëna në dispozicion në përputhje me këtë ligj.
13. “Korniza Referuese Gjeodezike” është baza mbi të cilën mbështetet përcaktimi unik tredimensional i pozicionit të një pike në tokë dhe përbëhet nga:
 - a) parametrat themelorë gjeodezikë;
 - b) sistemi i koordinatave gjeodezike;

c) sistemi i lartësive;
ç) sistemi i koordinatave në plan, i cili mbështetet te koordinatat gjeodezike dhe në projektionin hartografik;

d) rrjeti gravimetrik dhe rrjetet e tjera gjeodezike;

dh) sistemi i emërtesave.

14. “Metadata” është informacioni që përshkruan të dhënat, grupet e të dhënave gjeohapësinore dhe shërbimet që lidhen me to, të cilat mundësojnë zbulimin, inventarizimin dhe përdorimin e të dhënave e të grupeve të të dhënave gjeohapësinore.

14/1. “Ministri” është ministri përgjegjës për mbrojtjen.

15. “Ndërveprueshmëria” është aftësia e sistemeve të ndryshme për të punuar bashkë, pa ndërhyrje manuale të përsëritura, në mënyrë që rezultati i bashkëveprimit të jetë i qartë dhe të çojë në rritjen e vlerës së shtuar të grupeve dhe shërbimeve të të dhënave.

16. “Palë e tretë” është çdo person fizik ose juridik, i ndryshëm nga autoriteti publik i përkufizuar në pikën 2 të këtij neni.

17. “Shërbime për informacionin gjeohapësinor” janë operacionet që mund të realizohen, përmes aplikacioneve kompjuterike, për informacionin gjeohapësinor, të dhënat dhe grupet e të dhënave gjeohapësinore ose për metadatat që lidhen me to.

18. “Të dhëna gjeohapësinore” është çdo e dhënë që i referohet në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë një vendi ose zone gjeografike të veçantë.

19. “Objekt gjeohapësinor” është përfaqësimi abstrakt i një fenomeni të botës reale lidhur me një vend ose zonë gjeografike të veçantë.

20. **Shfuqizohet.**

Neni 4 **Parimet**

Krijimi i infrastrukturës kombëtare të të dhënave gjeohapësinore në Republikën e Shqipërisë udhëhiqet nga parimet e:

- a) ligjshmërisë;
- b) mbrojtjes së interesit publik;
- c) informimit të publikut me informacionin zyrtar;
- ç) mbrojtjes së të dhënave personale;
- d) mbrojtjes së pronësisë intelektuale;
- dh) transparencës;
- e) zhvillimit të qëndrueshëm;
- ë) ofrimit të shërbimeve me cilësi përkundrejt kostove efektive.

KREU II AUTORITETET KOMBËTARE TË INFRASTRUKTURËS SË INFORMACIONIT GJEOHAPËSINOR

Neni 5

Struktura kombëtare e informacionit gjeohapësinor

1. Autoritetet kombëtare përgjegjëse për informacionin gjeohapësinor janë Autoriteti Shtetëror i Informacionit Gjeohapësinor (ASIG), Bordi i Informacionit Gjeohapësinor (BIG) dhe autoritetet publike përgjegjëse për mbledhjen, përpunimin dhe përditësimin e informacionit gjeohapësinor, sipas legjislacionit në fuqi.

2. ASIG-u është institucion vendimmarrës, ekzekutiv dhe koordinues që mbikëqyr zbatimin e këtij ligji dhe të akteve nënligjore, të nxjerra në zbatim të tij.

3. BIG-u është organ këshillimor që ushtron veprimtarinë e tij me kohë të pjesshme dhe mblidhet

sa herë që është e nevojshme për realizimin e veprimtarisë së përcaktuar sipas pikës 2 të nenit 10 të këtij ligji.

4. Autoritetet publike përgjegjëse për mbledhjen, përpunimin dhe përditësimin e informacionit gjeohapësinor janë autoritetet e parashikuara në pikën 2 të nenit 3 të këtij ligji, të cilat, sipas legjislacionit në fuqi, ngarkohen me këto përgjegjësi.

Neni 6

Autoriteti Shtetëror i Informacionit Gjeohapësinor

1. ASIG-u është institucion publik qendror, me personalitet juridik, në varësi të ministrit përgjegjës për mbrojtjen.

2. ASIG-u e ka selinë në Tiranë dhe financohet nga Buxheti i Shtetit dhe të ardhura të tjera, të ligjshme.

3. Rregulla të hollësishme për mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të ASIG-ut miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit.

Neni 7

Përgjegjësitë e ASIG-ut

ASIG-u ka këto përgjegjësi:

- a) zbaton politikën kombëtare për infrastrukturën kombëtare të informacionit gjeohapësinor;
- b) është përgjegjës për projektimin, ndërtimin, mirëmbajtjen dhe përditësimin e Kornizës Referuese Gjeodezike;
- c) merr vendime për mbledhjen, përpunimin dhe përditësimin e informacionit gjeohapësinor nga autoritetet publike, sipas temave përkatëse;
- ç) përcakton standardet shtetërore dhe rregullat uniforme për krijimin e GIS-it, për secilën temë, dhe për krijimin e GIS-it Kombëtar, në përputhje me standardet europiane përkatëse dhe harton rregullat që lidhen me krijimin, përditësimin, shkëmbimin, aksesin dhe përdorimin e informacionit gjeohapësinor dhe shërbimeve që lidhen me të;
- d) siguron ndërveprueshmërinë e grupeve dhe shërbimeve të informacionit gjeohapësinor, si dhe harton rregulla të hollësishme për realizimin e ndërveprueshmërisë;
- dh) administron informacionin gjeohapësinor të mbledhur, të përpunuar dhe të përditësuar nga autoritetet publike, sipas temave përkatëse;
- e) siguron bashkërendimin e punës gjatë aktiviteteve dhe marrjes së nismave që lidhen me informacionin gjeohapësinor në sektorin publik dhe privat;
- ë) krijon dhe administron Gjeoportalin Kombëtar dhe garanton aksesin e publikut dhe subjekteve të interesuara, në përputhje me dispozitat e këtij ligji;
- f) mbikëqyr zbatimin e kuadrit rregullator të vendosur nga ky ligj, aktet nënligjore të dala në zbatim të këtij ligji dhe, në përputhje me politikat e zhvillimit të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave, u paraqet autoriteteve përkatëse propozime për ndërhyrje legjislative që lidhen me to;
- g) kujdeset për edukimin dhe rritjen e kapaciteteve të aktorëve të përfshirë në proceset që lidhen me infrastrukturën kombëtare të informacionit gjeohapësinor, si dhe për përhapjen e informacionit që lidhet me të te grupet e interesit dhe te publiku;
- gj) përfaqëson shtetin në organizatat europiane dhe ndërkombëtare, anëtarësimi në të cilat i shërben funksionimit dhe modernizimit të infrastrukturës kombëtare të informacionit gjeohapësinor;
- h) përfaqëson shtetin për çdo çështje tjetër që lidhet me infrastrukturën e informacionit gjeohapësinor;
- i) mbledh, analizon, administron, përpunon me teknologji të avancuar dhe shpërndan informacionin gjeohapësinor të mbledhur me metodat pasive dhe aktive të Remote Sensing-ut.
- j) krijon dhe mirëmban hartën bazë në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm (aktet nënligjore në fuqi të dala në zbatim të këtij ligji).

Neni 8
Drejtori i Përgjithshëm i ASIG-ut

1. Drejtori i Përgjithshëm i ASIG-ut drejton, organizon dhe mbikëqyr veprimtarinë e institucionit dhe është përgjegjës për mirëfunksionimin e tij, si dhe përfaqëson institucionin në marrëdhënie me të tretët.
2. Drejtori i përgjithshëm i ASIG-ut emërohet, lirohet ose shkarkohet nga Kryeministri, me propozim të ministrit.
3. Drejtori i Përgjithshëm duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:
 - a) të jetë shtetas shqiptar;
 - b) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
 - c) të zotërojë të paktën diplomë të nivelit “Master i shkencave” apo “Master profesional” të përfituar në fund të studimeve të ciklit të dytë me 120 kredite dhe me kohëzgjatje normale 2 vite akademike;
 - ç) të ketë përvojë pune jo më pak se 5 vjet në pozicione drejtuese;
 - d) të mos jetë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;
 - dh) ndaj tij të mos jetë marrë masë disiplinore e largimit nga puna, që nuk është shuar sipas legjislacionit në fuqi;
 - e) të mos ketë konflikt interesi në ushtrimin e detyrës, në përputhje me legjislacionin e konfliktit të interesave.
4. drejtori i Përgjithshëm lirohet nga detyra kur:
 - a) ka mbushur moshën për pension;
 - b) deklarohet i paaftë për punë nga komisioni kompetent mjekësor;
 - c) ristrukturohet institucioni;
 - ç) gjendet në një situatë konflikti të vazhdueshëm interesi;
 - d) jep dorëheqjen nga detyra;
 - dh) humbet shtetësinë shqiptare;
 - e) merr formë të prerë vendimi i gjykatës për kufizimin apo heqjen e zotësisë për të vepruar.
5. Drejtori i Përgjithshëm shkarkohet nga detyra kur:
 - a) dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtje penale me dashje;
 - b) kryen shkelje të rënda gjatë detyrës;
 - c) nuk përmbush objektivat strategjike të institucionit për shkak të performancës së ulët të tij;
 - ç) i shkakton, për shkak të paaftësisë profesionale a të neglizhencës, dëm institucionit ose imazhit të tij.

Neni 9
Nëpunësit e ASIG-ut

1. Marrëdhëniet e punës së punonjësve të ASIG-ut rregullohen sipas dispozitave të Kodit të Punës.
2. Struktura dhe organika e ASIG-ut miratohen nga Kryeministri, në përputhje me legjislacionin në fuqi për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore.

Neni 10
Bordi i Informacionit Gjeohapësinor

1. BIG-u është organ këshillimor i ASIG-ut dhe i Këshillit të Ministrave për zhvillimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit gjeohapësinor.
2. Përbërja, fusha e veprimtarisë, të ftuarit në mbledhjet e BIG-ut, si dhe rregullat më të hollësishme për mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të këtij bordi përcaktohen me urdhër të

Kryeministrit.

KREU III
TË DHËNAT GJEOHAPËSINORE, METADATAT
DHE GIS-I KOMBËTAR

Neni 11

Temat e të dhënave gjeohapësinore

1. Të dhënat gjeohapësinore krijohen, mblidhen, përditësohen dhe vihen në dispozicion të publikut, në përputhje me rregullat dhe afatet e përcaktuara nga ky ligj dhe nga aktet nënligjore, të dala në zbatim të tij, sipas klasifikimit dhe përkatësisë së tyre në temat e veçanta.

2. Temat e të dhënave gjeohapësinore përfshijnë:

- a) përcaktimin e kornizës referuese gjeodezike dhe kontrollin gjeodezik;
- b) sistemet e rrjeteve gjeografike;
- c) emërtimet gjeografike;
- ç) **harta bazë**;
- d) kufijtë e njësive administrative;
- dh) sistemin e adresave;
- e) parcelat kadastrale;
- ë) rrjetet e transportit;
- f) hidrografinë;
- g) zonat e mbrojtura;
- gj) modelin dixhital të terrenit;
- h) mbulesën e tokës;
- i) ortoimazherinë;
- j) gjeologjinë;
- k) njësitë statistikore;
- l) ndërtesat;
- ll) pedologjinë;
- m) përdorimin e tokës;
- n) shëndetin e njerëzve dhe sigurinë e tij;
- nj) infrastrukturën urbane dhe shërbimet qeveritare;
- o) infrastrukturën për monitorimin e mjedisit;
- p) infrastrukturën industriale;
- q) infrastrukturën bujqësore dhe akuakulturën;
- r) demografinë;
- rr) zonat me përdorim të kufizuar;
- s) zonat me rreziqe natyrore;
- sh) kushtet atmosferike;
- t) meteorologjinë;
- th) hidrologjinë;
- u) detet;
- v) zonat ekologjike;
- x) habitatet;
- xh) shpërndarjen e specieve;
- y) burimet energjetike;
- z) burimet minerare.

3. Listës së përcaktuar në pikën 2 të këtij neni i shtohet çdo temë tjetër e përcaktuar, rast pas rasti, me vendim të Këshillit të Ministrave, në përputhje me nevojat dhe zhvillimet në fushën e informacionit gjeohapësinor dhe në përputhje me përparësitë e politikës kombëtare të informacionit gjeohapësinor.

Neni 12

Mbledhja, përpunimi dhe përditësimi i të dhënave gjeohapësinore

1. Mbledhja, përpunimi dhe përditësimi i të dhënave gjeohapësinore për secilën nga temat e përcaktuara nga neni 11 i këtij ligji, kryhen në përputhje me vendimet e ASIG-ut për secilën temë.

2. Në vendimin e ASIG-ut për secilën temë identifikohen autoritetet publike përgjegjëse për mbledhjen, përpunimin dhe përditësimin e të dhënave gjeohapësinore përkatëse, si dhe përcaktohen afatet për mbledhjen e të dhënave dhe depozitimin e tyre pranë këtij autoriteti.

3. Autoritetet publike, të identifikuara sipas pikës 2 të këtij neni, mbledhin, përpunojnë dhe përditësojnë të dhëna gjeohapësinore, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe vendimet e ASIG-ut, si dhe depozitojnë pranë këtij autoriteti të dhënat gjeohapësinore të mbledhura në afatin e përcaktuar prej tij.

4. ASIG-u, pasi të ketë marrë më parë mendimin e BIG-ut për përputhshmërinë e tyre me kërkesat/kushtet e përcaktuara, miraton ose refuzon përfshirjen në GIS-in Kombëtar të të dhënave të mbledhura në përputhje me këtë nen.

5. Vendimi i ASIG-ut për miratimin e të dhënave gjeohapësinore dhe përfshirjen e tyre në GIS-in Kombëtar publikohet në Gjeoportalin Kombëtar, si dhe u komunikohet me shkrim autoriteteve publike përgjegjëse, brenda 15 ditëve nga data e marrjes së këtij vendimi.

6. Vendimi i ASIG-u për refuzimin e përfshirjes së të dhënave gjeohapësinore në GIS-in Kombëtar shoqërohet me arsyetimin përkatës dhe u përcillet me shkrim autoriteteve publike përgjegjëse, duke përcaktuar afatin, brenda të cilit këto autoritete duhet të adresojnë shkaqet e refuzimit, të sqaruara në arsyetimin e vendimit.

Neni 13

Metadat

1. Autoritetet publike përgjegjëse për krijimin ose mbajtjen e të dhënave gjeohapësinore, të parashikuara në nenin 2 të këtij ligji, në bashkëpunim me ASIG-un, krijojnë, mbledhin dhe përditësojnë metadat për këto të dhëna, në përputhje me këtë ligj dhe me rregullat e përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

2. Metadatat përmbajnë informacion për:

a) përputhshmërinë e grupeve të të dhënave gjeohapësinore me rregullat e ndërveprueshmërisë së grupeve të të dhënave gjeohapësinore, të miratuara nga Këshilli i Ministrave;

b) kushtet në lidhje me aksesin dhe përdorimin e grupeve të të dhënave gjeohapësinore dhe shërbimeve të të dhënave gjeohapësinore dhe, kur është rasti, edhe për tarifën korresponduese;

c) cilësinë dhe vlefshmërinë e grupeve të të dhënave gjeohapësinore;

ç) autoritetet publike përgjegjëse për krijimin, administrimin, mirëmbajtjen dhe shpërndarjen e grupeve të të dhënave gjeohapësinore dhe shërbimeve të të dhënave gjeohapësinore;

d) kufizimet për aksesin publik dhe arsyet e këtyre kufizimeve, në përputhje me rregullat e përcaktuara në nenin 25 të këtij ligji.

3. Autoritetet publike përgjegjëse për krijimin e metadatave sigurojnë që metadatat të jenë të plota dhe në një cilësi të tillë që të plotësojnë qëllimin e përcaktuar në pikën 13 të nenit 3 të këtij ligji.

4. Rregulla më të hollësishme për krijimin, ruajtjen dhe përditësimin e metadatave, për strukturën e katalogimit të metadatave, si dhe për afatet për krijimin e metadatave specifike për temat e parashikuara në pikën 2 të nenit 11 të këtij ligji, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, pasi të ketë marrë miratimin e BIG-ut dhe duke mbajtur në konsideratë standardet europiane ekzistuese për këtë qëllim dhe kërkesat për përdoruesit.

Neni 14

Ruajtja dhe arkivimi i të dhënave gjeohapësinore dhe metadatave

1. ASIG-u është institucioni përgjegjës për përcaktimin e kushteve për ruajtjen dhe arkivimin e të dhënave gjeohapësinore dhe metadatave, të cilat mbahen nga autoritetet publike përkatëse dhe ASIG-u.

2. Në përcaktimin e kushteve për ruajtjen dhe arkivimin e të dhënave gjeohapësinore dhe metadatave, ASIG-u mban në konsideratë legjislacionin në fuqi për bazat e të dhënave shtetërore.

Neni 15

Administrimi i të dhënave gjeohapësinore

1. ASIG-u është institucioni përgjegjës për administrimin e të dhënave gjeohapësinore të mbledhura, të përpunuara dhe të përditësuara nga autoritetet publike sipas nenit 12 të këtij ligji.

2. Të dhënat gjeohapësinore, të miratuara sipas pikës 4 të nenit 12 të këtij ligji, integrohen në GIS-in Kombëtar dhe u nënshtrohen dispozitave të këtij ligji për publikimin dhe përdorimin e tyre nga subjektet publike dhe private. Të dhënat gjeohapësinore të miratuara sipas pikës 4 të nenit 12 të këtij ligji, mund të administrohen nga autoritetet publike që i prodhojnë ato vetëm për qëllime të realizimit të funksioneve të tyre publike.

3. Për grupet e të dhënave gjeohapësinore, për të cilat një palë e tretë gëzon të drejta të pronësisë intelektuale, autoriteti publik nuk mund të veprojë në zbatim të këtij ligji pa pëlqimin e kësaj pale.

Neni 16

Përcaktimi i standardeve dhe rregullave uniforme

1. ASIG-u është autoriteti përgjegjës për përcaktimin e standardeve shtetërore dhe rregullave uniforme të infrastrukturës së informacionit gjeohapësinor, të cilat, pas marrjes së mendimit të BIG-ut, miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

2. Standardet shtetërore përfshijnë standardin e GIS-it Kombëtar dhe standardet shtetërore të sistemeve të informacionit gjeografik, sipas temave të parashikuara në nenin 11 të këtij ligji, ose të miratuara nga ASIG-u.

3. Në përcaktimin e standardeve shtetërore, sipas pikave 1 dhe 2 të këtij neni, ASIG-u mban në konsideratë standardet europiane, të miratuara nga organizmat standardizues europianë.

4. Në rregullat uniforme përcaktohen hapat administrativë dhe teknikë që duhet të përmbushin autoritetet publike dhe subjektet private për krijimin e sistemeve të informacionit gjeografik.

Neni 17

Sistemet e informacionit gjeografik

1. ASIG-u është autoriteti përgjegjës për ngritjen e GIS-it Kombëtar, në përputhje me standardet dhe rregullat e miratuara sipas pikës 1 të nenit 16 të këtij ligji.

2. Autoritetet publike, të identifikuara sipas pikës 2 të nenit 12 të këtij ligji, janë përgjegjëse për ngritjen e sistemeve të informacionit gjeografik, në përputhje me standardet dhe rregullat e miratuara sipas pikës 1 të nenit 16 të këtij ligji.

3. Autoritetet publike depozitojnë menjëherë pranë ASIG-ut informacionin gjeografik, të krijuar sipas pikës 2, të këtij neni.

4. ASIG-u, pasi merr mendimin e BIG-ut për përputhshmërinë e tyre me standardet dhe rregullat uniforme të miratuara për sistemin përkatës, miraton ose jo sistemin e informacionit gjeografik dhe përfshirjen e tij në GIS-in Kombëtar.

5. Vendimi i ASIG-ut për miratimin e sistemit të informacionit gjeografik dhe përfshirjen e tij në GIS-in Kombëtar publikohet në Gjeoportalin Kombëtar, si dhe i komunikohet me shkrim autoritetit publik përgjegjës, brenda 15 ditëve nga data e marrjes së këtij vendimi.

Neni 18

Ndërveprueshmëria

1. ASIG-u, në bashkëpunim me autoritetet publike përkatëse, merr masat e nevojshme për të siguruar ndërveprueshmërinë e grupeve dhe shërbimeve të të dhënave gjeohapësinore, për të dhënat gjeohapësinore ekzistuese dhe për ato që mblidhen pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, si dhe për metadat korresponduese.

2. Me qëllim sigurimin e ndërveprueshmërisë së grupeve dhe shërbimeve të të dhënave gjeohapësinore, ASIG-u, në bashkëpunim me autoritetet publike përkatëse, përcakton përkufizimin dhe klasifikimin e grupeve të të dhënave gjeohapësinore, që lidhen me temat e përcaktuara në pikën 2 të nenit 11 të këtij ligji, si dhe për mënyrën e gjeoreferencimit të këtyre të dhënave gjeohapësinore.

3. ASIG-u, në bashkëpunim me autoritetet publike përkatëse, harton rregulla të hollësishme për realizimin e ndërveprueshmërisë dhe, pasi të ketë marrë mendimin e BIG-ut, **ia përcjell rregullat ministrit për propozim**, për miratim në Këshillin e Ministrave. Këto rregulla duhet të përmbajnë parashikime edhe për aspektet e mëposhtme:

a) një kuadër të përbashkët për identifikimin unik të objekteve gjeohapësinore, identifikuesit e të cilëve mund të përcaktohen në hartë, me qëllim sigurimin e ndërveprueshmërisë midis tyre;

b) lidhjen midis objekteve gjeohapësinore;

c) atributet kryesore dhe sinonimet shumëgjuhëshe korresponduese; ç) informacionin për dimensionin kohor të të dhënave;

d) përditësimet e të dhënave.

4. Rregullat për ndërveprueshmërinë, sipas pikës 3 të këtij neni, duhet:

a) të sigurojnë përputhshmërinë midis zërave të informacionit që i referohen së njëjtës vendndodhje ose të njëjtit objekt të paraqitur në shkallë të ndryshme;

b) të sigurojnë që informacioni i nxjerrë nga grupe të ndryshme të dhënash gjeohapësinore është i krahasueshëm për sa i përket aspekteve të përcaktuara në pikat 2 dhe 3 të këtij neni.

5. Çdo informacion i nevojshëm për përputhshmërinë me rregullat e ndërveprueshmërisë, të miratuara në përputhje me këtë nen, përfshirë edhe të dhëna, kode dhe klasifikime teknike, u vihet në dispozicion autoriteteve publike dhe palëve të treta, sipas kushteve që nuk kufizojnë përdorimin e këtij informacioni për këtë qëllim.

6. Për të siguruar përputhshmërinë e të dhënave gjeohapësinore, që lidhen me një fenomen që shtrihet midis kufirit shqiptar dhe atij të një shteti tjetër, përshkrimi dhe vendndodhja e këtij fenomeni të përbashkët vendoset me pëlqimin e të dyja shteteve.

KREU IV

BASHKËPUNIMI NDËRINSTITUCIONAL DHE KOORDINIMI

Neni 19

Shkëmbimi i të dhënave gjeohapësinore

1. Autoritetet publike shkëmbejnë ndërmjet tyre grupet dhe shërbimet e të dhënave gjeohapësinore, të miratuara nga ASIG-u, sipas pikës 4 të nenit 12 të këtij ligji, duke i garantuar njëri-tjetrit aksesin tek ato dhe përdorimin e tyre për qëllime të ushtrimit të funksioneve të tyre publike.

2. Shkëmbimi i të dhënave, sipas pikës 1 të këtij neni, mund të kufizohet me vendim të ASIG-ut, në rastet kur prej tij rrezikohen proceset gjyqësore, siguria publike, mbrojtja kombëtare ose marrëdhëniet ndërkombëtare.

3. Rregulla më të hollësishme për shkëmbimin e grupeve dhe shërbimeve të të dhënave gjeohapësinore ndërmjet autoriteteve publike miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, duke pasur në konsideratë nevojën e shmangies së kufizimeve që mund të krijojnë pengesa praktike për shkëmbimin e grupeve dhe shërbimeve të të dhënave gjeohapësinore, të cilat ndodhin në pikën e përdorimit.

Neni 20

Koordinimi ndërinstitucional

1. ASIG-u, në përputhje me përgjegjësitë e tij sipas këtij ligji, bashkërendon veprimet dhe nismat e autoriteteve publike në fushën e informacionit gjeohapësinor. ASIG-u siguron **koordinimin ndërinstitucional** për:

- a) mbledhjen, përpunimin dhe përditësimin e të dhënave gjeohapësinore;
- b) përcaktimin e standardeve shtetërore dhe të rregullave uniforme;
- c) investimet në sektorin e të dhënave gjeohapësinore.

2. Autoritetet publike i paraqesin ASIG-ut kërkesën për vlerësimin e çdo nisme në fushën e infrastrukturës së të dhënave gjeohapësinore, e cila përmban të dhëna teknike dhe financiare të plota, si dhe shoqërohet me dokumentacionin teknik dhe financiar përkatës.

3. ASIG-u, brenda 10 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës, sipas pikës 2 të këtij neni, i përcjell për mendim BIG-ut kërkesën e autoritetit publik dhe dokumentacionin teknik e financiar përkatës.

4. ASIG-u, pasi merr mendimin e BIG-ut, në përputhje me dispozitat e këtij ligji, i përcjell autoritetit publik rekomandimin e tij të arsyetuar për nismën. Rekomandimi i ASIG-ut publikohet në Gjeoportalin Kombëtar.

Neni 21

Rekomandimi i ASIG-ut për nismat e autoriteteve publike

Në rekomandimin e ASIG-ut drejtuar autoritetit publik përfshihen:

- a) sugjerime teknike dhe financiare për realizimin e nismës;
- b) mendime për standardet dhe rregullat që duhet të zbatojë autoriteti publik;
- c) të dhëna për autoritetet e tjera publike, të përfshira në këtë nismë;
- ç) të dhëna për nisma dhe veprime që janë në proces zbatimi ose janë përfunduar e dorëzuar nga autoritete të tjera publike, të cilat duhen mbajtur parasysh gjatë procesit të zbatimit të nismës;
- d) çdo rekomandim tjetër që konsiderohet i rëndësishëm për mbarëvajtjen e procesit të zbatimit të nismës.

Neni 22

Bashkëpunimi me aktorë të tjerë

1. ASIG-u, përveçse me autoritetet publike, bashkëpunon ngushtë me sektorin privat dhe akademik, me qëllim krijimin e një baze të dhënash gjeohapësinore sa më gjithëpërfshirëse.

2. Autoritetet publike bashkëpunojnë ndërmjet tyre, por dhe me sektorin privat, për realizimin e nismave të përbashkëta, shkëmbimin e të dhënave gjeohapësinore të prodhuara prej tyre, zhvillimin e teknologjisë së gjeoinformacionit dhe pasurimin e bazës së të dhënave gjeohapësinore.

3. Për të siguruar bashkëpunimin, sipas pikave 1 dhe 2 të këtij neni, ASIG-u dhe autoritetet publike informojnë në mënyrë shkresore dhe/ose nëpërmjet Gjeoportalit Kombëtar subjektet private dhe akademike për nismat e ndërmarrja prej tyre, në zbatim të këtij ligji, si dhe i ftojnë ata të marrin pjesë dhe të shprehin mendimin e tyre në mënyrë shkresore dhe/ose nëpërmjet pjesëmarrjes në mbledhjet e ASIG-ut dhe/ose të BIG-ut, të organizuara për këtë qëllim.

Neni 22/1

Monitorimi dhe raportimi

1. ASIG-u monitoron procesin e krijimit dhe përdorimit të infrastrukturës kombëtare të informacionit gjeohapësinor (NSDI) në Republikën e Shqipërisë.

2. ASIG-u përgatit raporte periodike për ecurinë e NSDI-së në Shqipëri, sipas modelit të përcaktuar në rregullat e legjislacionit evropian dhe ua vë në dispozicion institucioneve shqiptare dhe organeve të BE-së.

KREU V
AKSESI TEK TË DHËNAT GJEOHAPËSINORE,
KUFIZIMET DHE KUSHTET

Neni 23

Shërbimet e rrjetit

1. ASIG-u vë në dispozicion të publikut të dhënat gjeohapësinore, për të cilat janë krijuar metadata, sipas këtij ligji dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, përmes një rrjeti që ofron shërbime:

a) kërkimi, me anë të të cilave bëhet i mundur kërkimi i grupeve dhe shërbimeve të të dhënave gjeohapësinore, në bazë të metadatave korresponduese dhe shfaqja e përmbajtjes së këtyre metadatave;

b) konsultimi, me anë të të cilave bëhen të mundur minimalisht shfaqja, lundrimi, zmadhimi apo zvogëlimi, shtresëzimi i grupeve të të dhënave gjeohapësinore që shfaqen dhe shfaqja e legjendës së informacionit dhe të çdo përmbajtjeje relevante të metadatave;

c) shkarkimi, me anë të të cilave mundësohet shkarkimi i kopjeve ose pjesëve të grupeve të të dhënave gjeohapësinore dhe, kur është rasti, aksesit i drejtpërdrejtë me to;

ç) transformimi, me anë të të cilave mundësohet transformimi i grupeve të të dhënave gjeohapësinore, me qëllim realizimin e ndërveprueshmërisë;

d) që lejojnë evokimin e shërbimeve për të dhënat gjeohapësinore.

2. Shërbimet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni ndërtohen duke mbajtur në konsideratë kërkesat që lidhen me përdoruesit, të cilat duhet të jenë lehtësisht të përdorshme, në dispozicion të publikut dhe të aksesueshme përmes internetit ose çdo mjete tjetër të përshtatshëm telekomunikacioni.

3. Për shërbimin e parashikuar nga shkronja “a” e pikës 1 të këtij neni duhet të zbatohet minimalisht kombinimi i mëposhtëm i kriterëve të kërkimit:

a) fjalët kyçe;

b) klasifikimi i të dhënave gjeohapësinore dhe shërbimeve që lidhen me to;

c) cilësia dhe vlefshmëria e grupeve të të dhënave gjeohapësinore;

ç) shkalla e përputhshmërisë me rregullat e ndërveprueshmërisë, të përcaktuara në pikat 3 dhe 4 të nenit 18 të këtij ligji;

d) vendndodhja gjeografike;

dh) kushtet, në lidhje me aksesin dhe përdorimin e grupeve dhe shërbimeve të të dhënave gjeohapësinore;

e) autoritetet publike përgjegjëse për krijimin, administrimin, mirëmbajtjen dhe shpërndarjen e grupeve dhe shërbimeve të të dhënave gjeohapësinore.

4. Shërbimi i transformimit, i parashikuar nga shkronja “ç” e pikës 1 të këtij neni, duhet të kombinohet me shërbimet e tjera të parashikuara në po të njëjtën pikë, në mënyrë të tillë që të mundësohet vënia në veprim e këtyre shërbimeve, në përputhje me rregullat e ndërveprueshmërisë, të përcaktuara në pikat 3 dhe 4 të nenit 18 të këtij ligji.

Neni 24

Gjeoportali Kombëtar

1. Metadata, të dhënat gjeohapësinore, grupet dhe shërbimet e të dhënave gjeohapësinore dhe shërbimet e rrjetit, të parashikuara nga ky ligj, aksesohen përmes Gjeoportalit Kombëtar.

2. Gjeoportali Kombëtar ndërlidh shërbimet e katalogimit, shërbimet e hartografisë në web dhe shërbimet e rrjetit, të parashikuara nga neni 23 i këtij ligji, me shtresat tematike të krijuara për të dhënat gjeohapësinore për secilën nga temat e parashikuara në pikën 2 të nenit 11 të këtij ligji.

3. Gjeoportali Kombëtar krijohet, mirëmbahet, përditësohet dhe aksesohet nën kujdesin e ASIG-ut dhe në përputhje me rregullat e përcaktuara nga ky autoritet.

4. ASIG-u, për krijimin e një vendi të sigurt për arkivimin dhe ruajtjen e informacionit të përfshirë në GIS-in Kombëtar, merr masat për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore në disa kopje, të cilat ruhen në ambiente të ndryshme dhe të rikuperimit nga katastrofa për Gjeoportalin Kombëtar.

Neni 25

Kufizimet

1. ASIG-u dhe autoritetet publike përkatëse kufizojnë aksesin publik te grupet dhe shërbimet e të dhënave gjeohapësinore për shërbimet e kërkimit, të përcaktuara nga shkronja “a” e pikës 1 të nenit 23 të këtij ligji, kur prej aksesit mund të rrezikohen siguria publike, mbrojtja kombëtare ose marrëdhëniet ndërkombëtare.

2. ASIG-u dhe autoritetet publike kufizojnë aksesin te grupet dhe shërbimet e të dhënave gjeohapësinore për shërbimet e parashikuara nga shkronjat “b”, “c”, “ç” dhe “d” të pikës 1 të nenit 23 të këtij ligji, kur nga aksesit mund të cenohen:

a) konfidencialiteti i procedurave të autoriteteve publike, i parashikuar me ligj;

b) marrëdhëniet ndërkombëtare, siguria publike ose mbrojtja kombëtare;

c) proceset gjyqësore, procesi i rregullt ligjor ose mundësia e autoriteteve publike për të kryer hetime penale ose administrative;

ç) konfidencialiteti i informacionit tregtar ose industrial, kur ai parashikohet nga legjislacioni shqiptar ose nga rregullat e një organizate ndërkombëtare, në të cilën Shqipëria është palë, për qëllime të mbrojtjes së interesave të ligjshëm me natyrë ekonomike, përfshirë edhe interesin publik në ruajtjen e konfidencialitetit statistikor dhe sekretin tatimor;

d) të drejtat e pronësisë intelektuale;

dh) konfidencialiteti i të dhënave personale dhe/ose i dosjeve që lidhen me një person fizik, kur ky i fundit nuk ka dhënë pëlqimin për përhapjen e këtij informacioni, dhe kur konfidencialiteti në lidhje me këtë informacion parashikohet nga ligji;

e) interesat ose mbrojtja e çdo personi që ka ofruar vullnetarisht informacionin e kërkuar, pa qenë i detyruar ligjërisht ta bëjë një gjë të tillë, përveçse kur ky person ka dhënë pëlqimin për përhapjen e informacionit;

ë) mbrojtja e mjedisit, me të cilin lidhet informacioni, si vendndodhja e specieve të rralla.

3. Arsyet e kufizimeve të parashikuara në pikën 2 të këtij neni vendosen duke mbajtur në konsideratë, rast pas rasti, interesin e publikut në përhapjen e informacionit dhe në interesin, të cilit i shërben kufizimi ose kushtëzimi i aksesit.

4. Aksesit te informacioni që lidhet me emetimet në mjedis nuk mund të kufizohet për shkaqet e parashikuara nga shkronjat “a”, “ç”, “dh”, “e” dhe “ë” të pikës 2 të këtij neni.

5. Për kufizimet e parashikuara nga shkronja “dh” e pikës 2 të këtij neni zbatohen dispozitat e ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të ndryshuar.

Neni 26

Ofrimi i të dhënave dhe shërbimeve

1. Të dhënat gjeohapësinore, të vëna në dispozicion nëpërmjet shërbimeve të rrjetit, sipas pikës 1, të nenit 23, të këtij ligji, që përfshihen në listën e grupeve të të dhënave me vlerë të madhe, sipas legjislacionit për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik, ofrohen pa pagesë nga ASIG-u

2. Të dhënat dhe shërbimet e ASIG-ut, që nuk përfshihen në pikën 1, të këtij neni, mund të ofrohen kundrejt një tarife.

3. Lista e të dhënave dhe shërbimeve që do të tarifohen, si dhe masa e tarifës përcaktohen me

vendim të Këshillit të Ministrave.

KREU VI DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 27

Aktet nënligjore

1. Kryeministri, brenda 2 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, miraton aktet nënligjore të parashikuara nga neni 9 pika 2 dhe neni 10 pika 2 të këtij ligji.

2. Këshilli i Ministrave, brenda 2 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, miraton aktin nënligjor të parashikuar nga neni 6 pika 3 i këtij ligji.

3. Këshilli i Ministrave, brenda 3 muajve nga fillimi i veprimtarisë së ASIG-ut, miraton aktet nënligjore të parashikuara nga neni 13 pika 4, neni 16 pika 1, neni 18 pika 3 dhe neni 19 pika 3 të këtij ligji, në bazë të parimeve të përcaktuara në nenin 4 të këtij ligji.

4. Ministri i Financave dhe ministri përgjegjës për të dhënat gjeohapësinore, brenda 1 muaji nga hyrja në fuqi e aktit nënligjor, të parashikuar nga neni 19 pika 3 e këtij ligji, miratojnë aktin nënligjor të parashikuar nga neni 26 pika 4 i këtij ligji, në bazë të parimit të ofrimit të shërbimeve me cilësi përkundrejt kostove efektive.

5. ASIG-u, brenda 6 muajve nga fillimi i veprimtarisë së tij, miraton rregullat e parashikuara nga neni 24 pika 3 i këtij ligji.

6. Ngarkohet Këshilli i Ministrave, që brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktin nënligjorë, në zbatim të nenit 26, pika 3 të këtij ligji

Neni 28

Dispozitë kalimtare

1. Për temat e parashikuara në pikën 2 të nenit 11 të këtij ligji, të dhënat gjeohapësinore dhe metadatat përkatëse krijohen brenda 5 viteve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

2. Të dhënat gjeohapësinore, të mbledhura, të ruajtura dhe të përditësuara nga autoritetet publike deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, i përcillen ASIG-ut brenda afateve të përcaktuara nga ky i fundit për secilin autoritet, në varësi të përkatësisë tematike të të dhënave. Përpara përfshirjes së këtyre të dhënave në GIS-in Kombëtar, ASIG-u përcakton afate për autoritetet publike për përshtatjen e këtyre të dhënave me standardet shtetërore dhe rregullat uniforme të infrastrukturës së informacionit gjeohapësinor, të parashikuara në nenin 16 të këtij ligji.

3. Buxheti i miratuar për vitin 2026 për Autoritetin Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor deri në rishikimin e ligjit nr. 87/2025 “Për buxhetin e vitit 2026” ekzekutohet në strukturën aktuale buxhetore në përputhje me rregullat e legjislacionit buxhetor në fuqi

Neni 29

Shfuqizime

Në nenin 4 pika 2, në nenin 5 pika 2 dhe në nenet 2, 6, 9, 12, 13, 14 dhe 16 të ligjit nr 8907, datë 6.6.2002 “Për funksionimin e Institutit Gjeografik Ushtarak të Shqipërisë”, fjalët “si dhe është autori i ndërtimit dhe i mirëmbajtjes së rrjetit gjeodezik shtetëror”, si dhe çdo dispozitë tjetër që bie në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen.

Neni 30

Hyrja në fuqi

1. Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në “Fletoren Zyrtare”.
Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në “Fletoren Zyrtare”
Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në “Fletoren Zyrtare”

Miratuar në datën 28.6.2012

Shpallur me dekretin nr.7721, datë 20.7.2012 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

Miratuar në datën 19.9.2024

Shpallur me dekretin nr. 354, datë 9.10.2024, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.

Miratuar në datën 21.5.2026

Shpallur me dekretin nr. 356, datë 12.6.2026, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.